# RELACION TEKNIK

**OBJEKTI: “RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT KUFIZUAR NGA RRUGA SAMI FRASHERI - PJETER BOGDANI - ANDON ZAKO CAJUPI - MOSKAT ”**

**Investitori:** Bashkia Tiranë

**Studio Projektuese:** ZENIT & CO sh.p.k

**Vendndodhja:** Rruga “Moskat”, Tirane

*Zenit & CO, zenit06@live.com Tiranë, 2023*

**Përmbatja:**

1. Te pergjithshme
2. Te dhenat dhe kerkesat e projektit
3. Gjëndja Ekzistuese
4. Nderhyrjet e propozuara

## 1. Te pergjithshme

Bazuar në kushtet teknike te projektimit per objektin **"RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT KUFIZUAR NGA RRUGA SAMI FRASHERI - PJETER BOGDANI - ANDON ZAKO CAJUPI - MOSKAT",** ZENIT & CO ka propozuar nje projekt i cili ofron nje zgjidhje funksionale dhe arkitektonike ne perputhje me KTP dhe KTZ.

## 2. Të dhëna dhe kërkesa të përgjithshme

**Objekti i studim - projektimit do të jetë:**

**"RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT KUFIZUAR NGA RRUGA SAMI FRASHERI - PJETER BOGDANI - ANDON ZAKO CAJUPI - MOSKAT"** ku propozohen sheshe te reja, me hapsira të gjelbëruara, të shfrytëzueshme dhe me të gjitha parametrat për zhvillimin e funksioneve përkatëset në kushte normale, duke respektuar kriteret teknike dhe standartet në fuqi.

## 3. Gjendja ekzistuese







Parcela e marre ne studim ndodhet ne zonen e “ish Bllokut” ne krahe te rruges “Moskat”. Sheshi ka disa hyrje edhe dalje si per makinat por edhe per kembesoret me nje sheshepushim te rrethuar nga godinat. Rruget e kalimit jane te amortizuara per shkak te permbytjeve e cila eshte problematika kryesore e vet bllokut te banimit dhe shqetesim per banoret e blokut. Gjithashtu blloku eshte i pa aksesueshem. Per kete propozohet nje rrugice e re. Rrugica eshte e nevojshme ne raste fatkeqesish ose rrezikshmerie ndaj zjarrit dhe problematikave te ndryshme qe kerkojne aksesim emergjence.









## 4. Nderhyrjet e propozuara




- Rikonstruksioni i rruges Andon Zako Cajupi. Propozohet riasfaltim pasi shtresa asfaltike eshte e demtuar gjithshtu propozohet zevendesim i pllakave dhe bordurave te trotuareve ekzistues dhe i bordurate pemeve dhe mbjellje te pemeve te reja.







- Rikonstruksion i rruges Moskat duke zevendesuar trotuarin ne krahun e bllokut dhe trotuar i ri ne pjesen e kundert ku eeshte pozicionuar edhe nje kunete per largimin e ujrave te shiut. Shtresa asfaltike eshte propozur riveshje me asfaltobeton.





- Sistemimi i shkalleve lidhese te bllokut me rrugen Sami Frasheri. Shkallet jane te demtuar nder vite dhe shfaqin rrezikshmeri. Shkallet jane me dimensione te ndryshme dhe te parregullta. Propozohet sistemimi i tyre me beton.




- Sistemimi i hapesires se brendshme te bllokut. Nga degjesa e banoreve eshte propozuar shtrimi i siperfaqes se brenshme me beton me zgare. Eshte realizuar konturimi i sheshit, ripozicionuar kunetat e ujrave te shiutqe te jene me te pershtatshme per largimin e ujrave te shiut. Ne pjesen e lidhjes se sheshit me rrugen Andon Zako Cajupi eshte propozuar nje zgare per te mos lejuar ujrat e shiut te rruges te mblidhen brenda bllokut.




MOS
PARKO


PAMJE 3D
POROSITESI / CLIENT
BASHKIA TIRANE
KONSULENT / CONSULTANT
"ZENIT&CO"sh.p.k
SHENIME TEKNIKE / TECHNICAL NOTES
OBJEKTI / PROJECT NAME
ZONA / LOCATION
BASHKIA TIRANE
TIRANE MUNICIPALITY
FAZA E PROJEKTIT / PROJECT PHASE
PROJEKT ZBATIMI
IMPLEMENTATION DESIGN
GRUPI I PROJEKTIMIT
EMERTIMI I FLETES / TITLE OF DESIGN
PAMJE 3D
SHKALLA: 1:---
SCALE: 1:---
GUSHT 2023
NR. FLETES / DRAWING NO.
P-09
VULA / STAMP




- Ne bllok mungon mundesia per tu aksesuar. Ne rast zjarri praktikisht behet e pamundur aksesimi i zjarrfikses. Gjithshtu edhe hyrja e dalja e makinave behet e veshtire. Per kete arsye eshte propozuar nje rruge e re qe lidh rrugen Moskat me hapesiren e bllokut. Rruga eshte me 1 kalim dhe eshte propozuar e asfaltuar. Rruga e re do i japi nje frymarje te nevojshme bllokut. Propozohet nderhyrja ne objektet 1 kate qe gjenden ne gjurmen e rruges.
- Persa i perket problematikes se permbytjeve per sa kohe nuk kemi nje pike shkarkimi me kuote me te ulet propozojme pastrimin e pusetave ekzistuese nga institucionet e bashkise dhe gjithshtu pozicionimin e nje pusete fundore qe te bej lidhjen me rrejti ekzistues te KUZ i mbrojtur me rrjete.




**GRUPI I PROJEKTIMIT:**

**ZENIT & CO sh.p.k**